



SHOQATA E BASHKIVE TE SHQIPERISE

Tiranë, më 24.05.2021
Voltana Ademi
Shoqata e Bashkive të Shqipërisë

Për:
Ambasadorët në Republikën e Shqipërisë
Drejtuesit e Misioneve të Huaja në Shqipëri
Partnerët e Shoqatës të Bashkive të Shqipërisë

Të nderuar Shkëlqesi,

Në emër të Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë (SHBESH), ne do të donim të ndanim me ju shqetësimet tona mbi një iniciativë të kohëve të fundit për të kapur ilegalisht shoqatën tonë, veprime të ndërmarra nga individë, anëtarë të Partisë Socialiste, pa të drejta legjitime dhe jo anëtarë SHBESH.

Siç mund ta dini, që nga viti 2009, ekzistojnë dy shoqata të qeverisjes vendore që veprojnë në Shqipëri. Fatkeqësisht, Kryetarët e Bashkive Socialiste menduan se ata nuk po përfaqësoheshin nga SHBESH dhe krijuan shoqatën e tyre, Shoqatën për Autonomi Vendore (SHAV). SHBESH respektoi vendimin e Kryetarëve të Bashkive dhe bashkëpunoi me SHAV në disa nisma në respekt të ndërsjellë të legjitimitetit të njëri-tjetrit.

Më 21 maj, 2021 pasdite, SHBESH mori një email dërguar nga Z. Pjerin Ndreu, drejtuar 14 bashkive të tjera, të cilat aktualisht janë anëtare të SHAV, me qëllimin që të organizojnë në mënyrë të paligjshme mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të SHBESH dhe për të zëvendësuar në mënyrë të paligjshme organet drejtuese të SHBESH. Ky veprim është në kundërshtim me statutin e SHBESH, pasi bashkitë kërkuese nuk janë anëtare të SHBESH.

Ne kemi dyshime serioze se ky takim online, ilegal, përmes platformës Zoom ka për qëllim të kapë kontrollin e përfaqësimit ligjor të SHBESH. Kjo do t'i mundësojë Kryetarit të ri (një Kryetar Socialist) të tërheqë ankesën e paraqitur nga SHBESH në Gjykatën Kushtetuese, kërkesë për vlerësimin e legjitimitetit të zgjedhjeve lokale të 30 qershorit 2019. Gjykata e ka vlerësuar kërkesën e SHBESH si të ligjshme dhe ne presim shqyrtimin e çeshtjes në një seancë plenare.

Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, shoqëria civile në Shqipëri, qytetarët shqiptarë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimi Evropian, Këshilli i Evropës, të gjithë partnerët dhe organizatat ndërkombëtare, janë në pritje të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, si një kusht që Shqipëria duhet të përmbushë në kuadrin e procesit për hapjen e negociatave të Integritimit Evropian.

SHBESH konsideron se demokracia lokale dhe sundimi i ligjit kanë një rëndësi të madhe. SHBESH shpreh vullnetin e saj për të respektuar ligjin dhe vendimin përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese.

Duke patur në konsideratë rolin tuaj të rëndësishëm në demokratizimin e shoqërisë shqiptare në përgjithësi, ndihmën tuaj në proceset zgjedhore dhe në reformën në sistemin e drejtësisë, ju ftojmë të ndiqni nga afër tentativat e paligjshme për të kapur Shoqatën e Bashkive të Shqipërisë, si një shkelje e autonomisë lokale dhe të drejtave tona kushtetuese.

Me respekt,

Voltana Ademi
Kryetare